

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO - Greqi -
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917756/greqi-vrasja-mafioze-ne-burg-dosja-e-alket-rizait-de-shmite-e-goditi-me-tre-plumba-ne-koke/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 07:16:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 06:56:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ca3b9d086d641a712a0c10454a501cb2fde6732d1bb02a6c75b6608e479d4c84
TEKSTI	67350e61a0418e257166b22c2289ca9ce14b6c7661673a8b26cfd1780d0f35c2
PAMJA	d3d6e31a79ce50b10298205bb58001056a2c636e2da29b667031a1ec559be895

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	12fb255f5e97dc46e19ac800567c8a69d552cda36866a3127c9147d8ae875fa0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2efc04bea43acf0f6a2e38be2863702e338fd789cd0cf3c1cc14a88f36ac9872
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/12fb255f5e97dc46e19ac800567c8a69d552cda36866a3127c9147d8ae875fa0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



më të lexuarat

Bllokimi i pagave të gjyqtarëve/ SPAK merr në pyetje përgjegjësen e Thesarit, ja çfarë dimë deri tani

Përfshihet nga flakët një makinë në një parkim nëntokësor në Fier

Shortohet seanca për Ergys Agasin e Ulian Shpatarakun- Ja kush gjyqtar e ka në dorë

Përdhunoi 32-vjeçaren dhe i plagosi babain! Sot masa e sigurisë për dajën e Zegjine Çaushtit

Dyshime për abuzime me pronat në Fier, pranga dy ish-drejtorëve të ASHK-së, specialisti dhe përfituesi

EMRAT/ Arrestohen në Itali dy shqiptarë, ja për çfarë akuzohen



Greqi - 'Vrasja mafioze' në burg, dosja e Alket Rizait! Dëshmitë: E goditi me tre plumba në kokë

08:56, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Emri i Alket Rizait, një prej personave më të njohur të botës së krimit në Greqi, del në dosjen për vrasjen e një të burgosuri të burgut të Domokos, më 15 shkurt 2026.

Rizai, i cili prej të hënës është në kërkim pasi u arratis nga burgu ku mbahej, dyshohet se ka qenë i pranishëm në ambientet ku u vra me tre plumba Antonis Papadatos. Emri i tij është rikthyer në vëmendjen e publikut edhe pas një incidenti me të shtëna në një beach bar në Anavyssos.

Sipas televizionit grek SKAI, çështja e vrasjes së Papadatos mbetet ende e hapur. Për ngjarjen është arrestuar dhe është lënë në paraburgim edhe kryegardiani i burgut të Domokos, i cili ndodhej në vendngjarje dhe, gjatë marrjes në pyetje, dyshohet se ka dhënë dëshmi kontradiktore.

Përdhunoj 32-vjeçaren dhe i plagosi babanë, gjykata lë në burg dajën e Zegjine Çausht



DEA amerikane ngre alarmin për mafien shqiptare/ Uruguaji: Po depërtojnë në vendin tonë



Në 'Porsche Cayenne' me lingota dhe monedha floriri, kush është 30 vjeçari i arrestuar në Fier

Ndërkohë, dëshmitë e mbledhura nga autoritetet e vendosin Alket Rizain në ambientet ku ndodhi vrasja, ndonëse ai mohon të ketë qenë aty.

SKAI ka publikuar për herë të parë fotografi nga vendi i krimit, ndërsa si autor i vrasjes akuzohet një i dënuar bullgar me burgim të përjetshëm.

Avokatja e familjes së viktimës ka deklaruar se që në momentet e para, versioni i dhënë nga kryegardisti i burgut ishte në kundërshtim me provat e mbledhura.

"Që në fillim, tabloja që dha ai ishte krejtësisht në kundërshtim me provat që dolën menjëherë dhe u lëshua edhe një urdhër arresti. Ajo që ndodhi është se brenda shtatë minutash, një i burgosur doli nga krahuri ku mbahej dhe u vra në ndërtesën e administratës", tha ajo.

Sipas raportimeve, në ngjarjen e përgjakshme dyshohet se ka pasur përfshirje edhe Alket Rizai. Ai mohon të ketë qenë në ambientin ku u vra Papadatos, por dëshmitarë okularë e vendosin atë në vendin ku ndodhi krimi.

Në dëshminë e tij, një punonjës i burgut ka deklaruar: "Në një moment dëgjova të shtëna që vinin nga ambienti i zyrës së vjetër të kryegardianit. Pashë që i pari doli Alket Rizai..."

Si ndodhi vrasja

Sipas pamjeve të kamerave të sigurisë së burgut, pak para se të gjendej i vrarë me tre plumba në kokë, Antonis Papadatos shihet në ambientin e përbashkët të sektorit D. Ai fliste me të burgosurit e tjerë dhe nuk dukej se ishte në dijeni të asaj që do të ndodhte.

Pak më vonë, në sektor shfaqet i dënuari bullgar me burgim të përjetshëm. Ai i kërkon Papadatos të dalë nga qelia dhe ta ndjekë. Papadatos e ndjek dhe të dy kalojnë nëpër korridoret e burgut në drejtim të zyrës së kryegardianit.

Sipas pamjeve, në drejtim të të njëjtit ambient shkon në të njëjtën kohë edhe Alket Rizai, i shoqëruar nga disa të burgosur të tjerë, të cilët dyshohet se vepronin si truproja të tij.

Në ambientet e administratës, sipas raportimit, Rizain e prisnin tashmë Antonis Papadatos, i dënuari bullgar dhe kryevardhësi i burgut.

Në pamjet filmike, kryegardiani shihet duke përshëndetur dhe përqaftuar Rizain. Më pas, të gjithë së bashku duket se e çojnë viktimën drejt zyrës së vjetër të kryegardianit, i vetmi ambient i burgut ku nuk kishte kamera sigurie.

Brenda kësaj dhome, ku nuk kishte mbulim nga kamerat, Papadatos u qëllua fillimisht në pjesën e pasme të kokës dhe më pas me dy plumba të tjerë në fytyrë.

I dënuari bullgar, i cili më pas mori përsipër përgjegjësinë për vrasjen, pretendon se Papadatos tentoi të vriste kryegardianin me një revolver që e kishte fshehur në pantallona të shkurtra. Sipas versionit të tij, ai u përpoq të kapte armën dhe gjatë përlëshjes arma u shkrept, duke plagosur për vdekje Papadatos në kokë.

Pas vrasjes së Papadatos, ngjarja duket se po hetohet nga policia dhe prokuroria më shumë si një ekzekutim i porositur sesa si një akt vetësakrifice, në kundërshtim me versionin e të dënuarit bullgar. Pas ngjarjes, ai dyshohet se e hodhi armën në dyshe me dhe u dorëzua.

Në dëshminë e tij, kryegardiani pretendon se gjatë incidentit u përpoq të fshihej dhe nuk pa se çfarë ndodhi. Ai gjithashtu ka deklaruar se Rizai ishte larguar nga ambienti disa minuta më parë.

Avokati i kryevardhësit, Dimitris Gavelas, tha: "Një kryegardian u gjend në vendin e gabuar, në momentin e gabuar. Ai u përball me një situatë që, me sa duket, nuk mund ta parandalonte. Nuk mund të jap ndonjë interpretim përtej asaj që thuhet në materialet e dosjes. Nëse klienti im pretendon se Rizai nuk ndodhej në vendin e krimit, nuk mund të bëj gjë tjetër veçse të dëgjoj atë që pretendon klienti im".

Vetë Rizai mohon çdo përfshirje në ngjarje.

"Jam i pastër dhe nuk kam frikë nga asgjë. Nuk isha brenda zyres së vjetër të kryegardianit në momentin kur ndodhi ngjarja. Nuk kisha asnjë arsye të përfshihesha në një çështje të tillë, as për të gjitha paratë e botës", ka deklaruar ai.

Megjithatë, sipas raportimit, ekspertët kriminalistikë kanë gjetur gjurmë gjaku në këpucët e tij dhe gjurmë baruti në veshjet e tij.

Sipas raportimit, 47-vjeçari i arratisur nuk është i akuzuar për vrasjen dhe vazhdon të konsiderohet dëshmitar në këtë çështje. Ndërkohë, kërkesa për lirim nga paraburgimi e paraqitur në gusht nga kryegardiani i burgut, i cili ndodhet në paraburgim, është rrëzuar.

Ndërsa kalojnë ditët, po forcohet edhe skenari se Alket Rizai, i njohur për lidhjen e tij të ngushtë me të shumëkërkuarin Vasilis Palaikostas, mund të jetë larguar drejt Shqipërisë.

Informacionet që kanë mbërritur te autoritetet greke bëjnë të ditur se gjurmët e fundit të Rizait janë lokalizuar në Greqinë e Veriut, nga ku dyshohet se mund të ketë kaluar ilegalisht drejt Shqipërisë.

Ky version nuk konsiderohet ende i konfirmuar, por sipas raportimeve, është një nga skenarët që po merret gjithnjë e më shumë në konsideratë nga autoritetet.



© SYRI.net

Lexo edhe:



Qiraja brenda qirasë/ 'Dua 120 mijë euro', si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit!



VIDEO/ Tmerri i 40-vjeçares në Vlorë, si u shndërrua njohja e re në një kalvar për ndjekjeje, shantazhi dhe denigrimi



Vlorë/ Zjarr në kuzhinën e një restoranti në Skelë, flakët përfshijnë garazhin nëntokësor

TË NGJASHME



VIDEO/ Pesë muaj pa të birin, nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës



Këta janë 3 fieraqet që humbën jetën tragjikisht në aksident në Athinë



Fëmija 1 vjeçar dëmtot dorën me grirëse mishi, niset me helikopter drejt Tiranës



Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni



Erion Veliaj del nga burgu, dërgohet me ambulancë në spital



Grabitet apartamenti i kardinalit Ernest Simoni në Firence, ja çfarë morën hajdutët.... Nipi: Kur e njoftova më pyeti për



Emri i një pensionisti u përdor për ndryshimin e 45 identiteteve. Pezullohen 2 zyrtarë, Indrit Aliu shpallet në kërkim



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.